



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS – OIRK

Data: 28.10.2025

Prishtinë

Drejtuar:

Z. Avni Ahmeti

Drejtor Ekzekutiv

Agjencia Kadastrale e Kosovës

Prishtinë

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Nr. I Prot. Org. Jedinica Org. Unit	OIRK
Nr. I Prot. Org. Jedinica Org. Unit	879/25
Nr. I Prot. Org. Jedinica Org. Unit	6
Nr. I Prot. Org. Jedinica Org. Unit	28.10.25
PRISHTINË / A No.1	

Lënda: Përgjigje ndaj shkresës suaj Ref. Nr. 01-1983/25, dt. 30.09.2025

I nderuar z. Ahmeti,

Në vijim të kërkesës suaj, ne parashtrojmë këtë përgjigje e bazuar thellë në legjislacionin e Republikës së Kosovës me referenca të plota nene/paragrafësh:

I. Kompetenca ligjore e OIRK-së për licencim profesional në ndërtim

Ligji Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (i botuar në Gazetën Zyrtare më 17.01.2022)

- **Neni 1:** „Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i profesionit të arkitektit dhe inxhinierit në fushën e ndërtimit.“
- **Neni 3.1.8:** Përkufizimi: „**Inxhinier i licencuar**“ është personi i licencuar për ushtrimin e profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit duke përfshirë inxhinierët e ndërtimit, inxhinierët e elektroteknikës, inxhinierët e makinerisë, si dhe **“profile të tjera të inxhinierisë që merren me fushën e ndërtimit.”**
- **Neni 23.1:** „Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të arkitektit dhe profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit në Republikën e Kosovës, duhet të aplikohet për anëtarësi në Odën përkatëse dhe nëse plotësohen kriteret e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore sipas këtij ligji, Oda lëshon licencë profesionale“.
- **Neni 3.1.2:** **“Oda e Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit –** është organizatë profesionale e pavarur e cila ka për qëllim të sigurojë që personat të cilët e ushtrojnë profesionin e inxhinierit në fushën e ndërtimit në Republikën e Kosovës të punojnë sipas ligjit në fuqi dhe në të njëjtën kohë, përfaqëson dhe mbrojnë interesat e tyre”;



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

- **Neni 4.1:** “Oda e ka statusin e personit juridik dhe funksionon si organizatë profesionale jofitimprurëse e cila ka për qëllim rregullimin e profesionit të arkitektit respektivisht inxhinierit në fushën e ndërtimit me qëllim ruajtjen e shëndetit, sigurisë publike dhe mbrojtjen e mjedisit”.

Statuti i OIRK-së përforcon:

- **Neni 3, par. 1:** Oda është organizatë profesionale jofitimprurëse e cila ka për qëllim rregullimin e profesionit të inxhinierit, me qëllim ruajtjen e shëndetit, sigurisë publike dhe mbrojtjen e mjedisit.
- **Neni 8, par. 1.1:** „Licencimi i inxhinierëve është kompetencë themelore e Odës.”
- **Neni 24, par. 1.20:** “Bordi Drejtues vendos për çështjet tjera të cilat janë të përcaktuara me këtë Statut dhe aktet e përgjithshme të Odës”.
- **Neni 24, par. 1.21:** “Bordi Drejtues vendos për çështjet të cilat nuk janë kompetencë e organeve të tjera të Odës”.

Në bazë të këtyre dispozitave, OIRK ka mandat të ligjshëm, të qartë dhe ekskluziv për licencimin e profesionistëve inxhinierikë që veprojnë në fushën e ndërtimit — përfshirë edhe inxhinierinë e gjeodezisë pasi kjo degë e inxhinierisë është kontribuese e pashmangshme në fushën e ndërtimit.

II. Sistemi i licencimit – Kategoritë A dhe B

Ligji Nr. 08/L-012, në përkufizimet e tij (p.sh., Neni 3.1.15 – “Licencë e Kategorisë A / Licencë e Kategorisë B”) përcakton ndarjen e licencave.

Më tutje, **Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 06/2023**, përcakton:

- **Neni 4:** Drejtime të inxhinierisë që licencohen – përfshirë shprehimisht „drejtime tjera të inxhinierisë që përfshihen në fushën e ndërtimit”.
- **Neni 5:** Procedura përshkruan ndarjen në “Kategori A” dhe “Kategori B” për inxhinierë që ofrojnë shërbime profesionale në fushën e ndërtimit.
- Në Rregulloren e OIRK-së, **Neni 5.1:** „Licencat profesionale për inxhinier ndahen në Kategori A dhe Kategori B.”

Kjo nënkupton që për çdo inxhinier që vepron në fushën e ndërtimit (pavarësisht profilit) duhet të ketë licencë të OIRK-së – dhe kjo përfshin inxhinierinë e gjeodezisë kur ajo është pjesë e procesit të ndërtimit.

III. Ligji i Kadastres – kufizim i kompetencave

Ligji Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme (09.01.2024):

- **Neni 1:** „Ky ligj ka për qëllim rregullimin e shërbimit publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në kadastër, administrimin e kadastrit dhe organizimin e institucionit përgjegjës.“
- **Neni 14(1):** „AKK-ja licencon kompanitë gjeodezike dhe gjeodetët për kryerjen e matjeve kadastrale dhe gjeodezike bazuar në këtë ligj“
- **Neni 28(1):** „Matjet gjeodezike bëhen me qëllim të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave informacioneve hapësinore nga terreni.“
- **Neni 28(2):** „Matjet gjeodezike nga paragrafi 1 i këtij neni (neni 28.1) shfrytëzohen për qëllime inxhinierie.“

Rezulton qartë se:

- Mandati i AKK-së është për matje kadastrale, regjistrim pronash dhe të dhëna hapësinore.
- Nuk ka kompetencë për të licencuar profesionin inxhinierik në fushën e ndërtimit.
- Edhe pse Ligji i Kadastres është botuar më vonë, ai nuk përmban dispozitë që shfuqizon Ligjin Nr. 08/L-012 ose ndonjë nen të tij që u heq të drejtën e përfshirjes së Inxhinierëve të Gjeodezisë në OIRK-së.

Për rrjedhojë, kompetenca e OIRK-së mbetet e pacenuar dhe e plotë.

IV. Roli i inxhinierisë së gjeodezisë në ndërtim

Inxhinierët e gjeodezisë kontribuojnë në mënyrë thelbësore në ndërtim me:

- Matje për kalkulim të sasive (germime, mbushje, volume, etj)
- Trasim i rrugëve, urave, tuneleve, hekurudhave, objekteve hidroteknike



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

- Kontroll gjeometrik i elementeve të strukturave
- Monitorim deformimesh, devijimesh, matje për pranim teknik, etj

Këto procedura janë profesionale inxhinierike, jo vetëm shërbime topografike. Prandaj licencimi i tyre nga OIRK është i domosdoshëm për sigurinë, vlerësimin teknik dhe ekzekutimin e saktë të punimeve.

Për më tej, rikujtojmë se roli i inxhinierit të gjeodezisë në proceset e ndërtimit është i përcaktuar shprehimisht në legjislacionin sektorial të ndërtimit, përfshirë Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe UA Nr. 05/2017 për Mbikëqyrjen Inspektuese dhe Procedurën për Lëshimin e Certifikatës së Përdorimit, të cilat e obligojnë pjesëmarrjen e inxhinierit të gjeodezisë në verifikimin e përputhshmërisë së vendndodhjes, koordinatave dhe dimensioneve të objektit me lejen e ndërtimit dhe dokumentacionin ekzekutiv, si dhe hartimin e Elaboratit Gjeodezik si pjesë e Raportit Final Teknik. Si profesionist i përfshirë drejtpërdrejt në sigurinë strukturore dhe gjeometrike të objektit, ai ushtron veprimtari inxhinierike në kuptim të plotë të Ligjit Nr. 08/L-012, dhe për këtë arsye i nënshtrohet licencimit, mbikëqyrjes profesionale dhe përgjegjësisë disiplinore nga OIRK, si autoriteti kompetent ligjor në fushën e ndërtimit.

Megjithatë OIRK nuk ka asnjë kundërshtim nëse inxhinierët e gjeodezisë të cilët janë anëtarë të dhe licencuar nga OIRK, të pajisen edhe me licenca nga AKK për kryerjen e matjeve kadastrale dhe gjeodezike bazuar në Ligjin Nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme (09.01.2024).

V. Përgjegjësia profesionale dhe disiplinore e inxhinierëve të licencuar

OIRK ka autoritet ekskluziv jo vetëm për licencim, por edhe për mbikëqyrje dhe përgjegjësi profesionale:

Kodi i Etikës,

Neni 1: Qëllimi “Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale përcakton parimet dhe rregullat bazë të sjelljes dhe etikës në ushtrimin e veprimtarisë profesionale të inxhinierëve, duke përmbushur kështu detyrimet e tyre ndaj publikut, klientëve, kolegëve të tyre dhe Odës.”

Neni 2: “Dispozitat e këtij Kodi janë të detyrueshme për të gjithë inxhinierët e licencuar në Republikën e Kosovës.”

Rregullorja për Procedurën Disiplinore,



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 5.1: "Inxhinieri i licencuar mban përgjegjësi disiplinore nëse me veprimin apo mosveprimin e tij në ushtrimin e veprimtarisë profesionale bën shkelje disiplinore. "

Neni 5.2: "Përgjegjësia për vepër penale apo kundërvajtje nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të inxhinierit të licencuar."

VI. Edukimi i vazhdueshëm profesional i inxhinierëve në fushën e ndërtimit

OIRK, si autoriteti ligjor që rregullon profesionin e inxhinierisë në fushën e ndërtimit, ka përgjegjësi ekskluzive për edukimin e vazhdueshëm profesional i të gjithë inxhinierëve të licencuar në këtë fushë — duke përfshirë inxhinierët e gjeodezisë kur ushtrimi i profesionit të tyre lidhet me proceset e ndërtimit. Ky sistem i organizuar i përditësimit të njohurive garanton që profesionistët të jenë në hap me zhvillimet teknike, teknologjike dhe rregullative, të avancojnë në mënyrë të vazhdueshme kompetencën e tyre dhe të kontribuojnë në rritjen e sigurisë dhe cilësisë së objekteve ndërtimore. Kjo kompetencë lidhet ngushtë me ushtrimin e profesionit inxhinierik dhe me mbrojtjen e interesit publik në ndërtim, prandaj nuk mund të zhvendoset apo zëvendësohet nga struktura administrative që kanë fokus të ndryshëm institucional. Vendosja e këtij standardi profesional nga OIRK siguron që çdo inxhinier në fushën e ndërtimit të jetë i përgatitur për të përmbushur kërkesat e kohës dhe përgjegjësitë që burojnë nga zhvillimet bashkëkohore në praktikën inxhinierike.

VII. Mekanizmat e përgjegjësisë profesionale në fushën e ndërtimit

Në fushën e ndërtimit, çdo veprim profesional i inxhinierit ndikon drejtpërdrejt në sigurinë dhe cilësinë e objekteve. Për këtë arsye, OIRK ka vendosur mekanizma të detyrueshëm të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për të gjithë inxhinierët e licencuar në fushën e ndërtimit, përfshirë inxhinierët e gjeodezisë si pjesë përbërëse e këtij sektori. Ky sigurim mbron publikun, investitorët dhe vetë profesionistin nga pasojat financiare dhe juridike të mundshme që mund të shkaktohen nga gabimet teknike. Ky mekanizëm nuk ekziston në asnjë strukturë tjetër institucionale, përfshirë AKK-në, pasi nuk ka mbështetje ligjore që të mbulojë përgjegjësinë profesionale në fushën e ndërtimit — kompetencë kjo që i takon vetëm OIRK-së.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

1. OIRK ka mandat ligjor dhe ekskluziv për licencimin e profesionistëve inxhinierikë në fushën e ndërtimit (Ligji 08/L-012).
2. Sistemi i licencave A dhe B përfshinë të gjitha profilimet profesionale në fushën e ndërtimit, përfshirë gjeodezinë.
3. Ligji i Kadastres (08/L-237) nuk prek licencimin profesional dhe nuk kufizon kompetencat e OIRK-së.

**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

4. Roli i inxhinierit të gjeodezisë në mbikëqyrjen inspektuese dhe Raportin Final Teknik është i përcaktuar në UA Nr. 05/2017 dhe Ligjin për Ndërtim, prandaj licencimi i tyre nga OIRK është detyrim ligjor për garantimin e përputhshmërisë teknike dhe sigurisë publike.
5. OIRK nuk është vetëm organ licencues, por mban edhe përgjegjësi profesionale dhe disiplinore ndaj inxhinierëve të licencuar, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e ndërtimit sipas Kodit të Etikës dhe rregulloreve të brendshme.
6. Edukimi i vazhdueshëm profesional i inxhinierëve në fushën e ndërtimit, përfshirë inxhinierët e gjeodezisë, është përgjegjësi ekskluzive e OIRK-së dhe përbën mekanizëm thelbësor për garantimin e sigurisë, cilësisë dhe zhvillimit profesional të qëndrueshëm në proceset ndërtimore.
7. Sigurimi i detyrueshëm profesional i OIRK mbulon gabimet dhe dëmet eventuale të çdo inxhinieri të licencuar — përfshirë edhe inxhinierët e gjeodezisë — duke siguruar mbrojtje financiare dhe juridike për publikun, investitorët dhe vetë profesionistin, në rast të shkeljeve teknike gjatë ushtrimit të profesionit.
8. Vendimi i Bordit të OIRK-së për licencimin e inxhinierëve të gjeodezisë mbetet i ligjshëm, i qëndrueshëm dhe pa asnjë pengesë ligjore dhe juridikisht i obligueshëm.
9. OIRK nuk ka asnjë kundërshtim nëse inxhinierët e gjeodezisë të pajisen edhe me licenca nga AKK për kryerjen e matjeve kadastrale dhe gjeodezike bazuar në Ligjin Nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme (09.01.2024).
10. OIRK është i hapur për bashkëpunim institucional në shërbim të sigurisë dhe cilësisë në ndërtim.

Me respekt të lartë profesional,

Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës

Përfaqësuar nga: Arsim RAPUCA, Kryetar

